




Festojmë artin

Të nderuar familjarë dhe kolegë,

Si mësues dhe si prind, e kam parë nga afër ndikimin e jashtëzakonshëm të artit te të rinjtë tanë. Kur nxënësit eksplorojnë dhe përjetojnë artin — qoftë duke marrë në dorë një penel apo një objekte skene, një aparat fotografik apo një klarinetë — vetëbesimi i tyre, aftësitë e të menduarit kritik dhe kreativiteti lulëzojnë.

Kjo është arsyeja pse jam krenare për punën që po bëjmë në shkollat publike të qytetit të Nju-Jorkut (NYCPS) për të promovuar arsimin artistik, duke i bërë komunitetet tona të shkollave hapësira edhe më të gjalla dhe ekspresive. Midis viteve shkollore 2023-24 dhe 2024-25, ne rritëm financimin për artin dhe shtuam numrin e mësuesve të artit me kohë të plotë në të gjithë sistemin tonë. Kemi investuar në ArtsHub, një qendër arti e NYCPS-së në Bruklin, ku nxënësit mund të ndërveprojnë me artistë profesionistë dhe ku mësuesit mund të marrin mbështetje për të vendosur artet në qendër të shkollave të tyre. Po ashtu, kemi zgjeruar rrugët e artit për nxënësit, duke përfshirë mësimet për violinë për nxënësit e parashkollorit, programet verore artistike dhe festivalet me tambure dhe daulle nëpër qarqe.

Në një qendër kulturore si të qytetit të Nju-Jorkut, frymëzimi artistik është kudo - dhe dua të falënderoj mësuesit, partnerët e komunitetit, financuesit dhe të tjerë që ndihmojnë në sjelljen

e këtij frymëzimi në klasat tona. Çdo ditë, ju po i ndihmoni nxënësit tanë të shprehen dhe të zbulojnë pasione të reja.

Në bashkëpunim,


Melissa Aviles-Ramos
Kancelare (Chancellor)

Fokusi i kancelares:

Këtë javë, zhvilluam [eventin tonë të vitit "Arti në shkollë"](#) në zyrën qendrore të NYCPS-së, ku festuam ndikimin e arsimit artistik. Eventu përfshinte një performancë nga Jazz House Teacher Fellows, një bursë e re për mësuesit e muzikës të NYCPS-së për të ndërtuar komunitet dhe për të përmirësuar praktikën e tyre. Për një përmbledhje të festës, shikoni videon tonë me momentet kryesore.

Nominoni një person ose program për fokusin e kancelares [këtu](#).

Video përmbledhëse:



Për përktime, ju lutemi vizitoni faqen tonë në [YouTube](#).

Për të aksesuar titrat e përktiera: Klikoni mbi ikonën "CC". Klikoni mbi ikonën "Settings (Cilësimet)" dhe zgjidhni "Subtitles/CC (Titrat/CC)". Zgjidhni "Auto Translate (Përktim Automatik)" dhe më pas zgjidhni gjuhën tuaj.

Lajme dhe burime nga NYCPS:

- Shikoni [mundësitë për nxënësit](#) këtë dhjetor në [The Morning Bell](#).
- Për të reja dhe burime të tjera, ndiqni NYCPS online në [Facebook](#), [Instagram](#), [X](#) dhe [YouTube](#).

- Për përditësime javore me video nga Kryetari i Bashkisë Eric Adams, vizitoni faqen [YouTube të Zyrës së Kryetarit të Bashkisë](#). Mund gjithashtu [të regjistroheni për të marrë përditësime](#) drejtpërdrejt nga Zyra e Kryetarit të Bashkisë.

Familje të NYCPS: Nëse nuk dëshironi më të merrni këtë buletin informativ, ju lutemi [çaktivizoni abonimin](#).